

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Diskutimi mbi buxhetin është një diskutim me shumë rëndësi dhe plot përgjegjësi për këtë Kuvend.

Duhet të marrim parasysh sot emigracionin masiv, dëshpërimin social, varfërinë ekonomike dhe duhet ta pyesim veten: si e prioritarizojmë në arsimin?

Strategjia e qeverisë sot ngjason me një skenar tejet optimist, ndoshta edhe pak propagandistik, sepse situata nuk reflektohet e tillë.

Qeveria në vitin 2013 premtoi se arsimit do të ishte në 5% të GDP-së, por, në fakt, është afërsisht 3% sot dhe, në vitin që jemi e po marrim në shqyrtim buxhetin, është 2,3%.

Shqipëria po lëngon sot, se rinia dita-ditës largohet dhe, natyrisht, lind pyetja: çfarë po bën qeveria për ta adresuar këtë fenomen? Sa nga këta objektiva do të depërtojnë vërtet në realitetin e fëmijëve dhe të rinjve?

Si fillim, duhet të kuptojmë që arsimit është elementi kyç për zhvillimin e shoqërisë, se edhe 5% e GDP-së është akoma një përqindje e ulët për arsimin. E si nuk është akoma në ato nivele, kur ju nuk e keni sjellë akoma në vlerën 5%, e sillni në vlerat 3%, 2,3%? Çfarë vlere? Çfarë keni bërë ju për rininë shqiptare?

Ky duhej të ishte fokusi ynë kryesor sot: rinia, arsimit, mbështetja për ta!

Dua ta nis me arsimin e lartë dhe sfidat që ne hasim sot.

Çdo i ri do të pohonte me të vërtetë se sfidat janë të panumërta, se infrastruktura universitare ka nevojë për përmirësime dhe investime serioze, se tarifat e studimeve janë të larta, tarifat e akomodimeve janë të larta dhe as akomodime nuk u ofrohen.

Pse nuk sigurohet mbështetja për studentët? Keni përmendur shpesh Paktin për Universitetin, por nuk i keni zbatuar premtimet që keni dhënë.

Në zbatim të urdhrit nr. 184, datë 26.12.2018 të Kryeministrit, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës ose GNP “Për vlerësimin e gjendjes dhe propozimin e masave për përmirësimin e infrastrukturës së kampusit universitar të Tiranës”, po ashtu edhe atij të Durrësit.

Sot ju e dini shumë mirë që edhe në Komisionin e Edukimit të gjithë rektorët e universiteteve u shprehën se kampuset nuk ekzistojnë, ndërkohë ministrja në Komisionin e Edukimit tha se janë dhënë 200 milionë lekë për projektin e kampusit të Universitetit të Tiranës. Ku është sot projekti që akomodon studentët në Tiranë? Ku është mbështetja për ta? Ku janë konviktet që do të akomodojnë studentët e kampusit universitar të Durrësit dhe të Tiranës? Ku në buxhetin që keni sjellë ju sot, është jetësuar ky premtim?

Ja, pra, që nuk është! Ja, pra, që ata janë të harruar!

Ministria e Arsimit dhe Sportit thotë se do të investojë në biblioteka, por nuk thuhet nëse do të ndërtojnë godina apo do të ketë hapësira për nxënësit dhe studentët. Ata thonë se kanë një fond në buxhetin e tyre përmes të cilit do të shpërndahen libra. Patjetër, është shumë pozitive që librat të shpërndahen, të kemi jetësim të çdo biblioteke. Por a kemi ne një bibliotekë prestigjioze për vendin tonë? Më përmendni një bibliotekë prestigjioze në të gjithë Shqipërinë, ku çdo student i universitetit mund të shkojë dhe çdo studim ta zhvillojë në atë hapësirë.

Ju keni bibliotekat më të varfra në të gjithë rajonin dhe asnjë godinë prestigjioze që u ofron studentëve komoditetin të punojnë në ato hapësira!

Sot na duhen më shumë se shifra në letra dhe projekte imagjinare, të nderuar kolegë, nevojiten politika zhvillimore, të ngrihet standardi infrastrukturor, sepse studentët e meritojnë sot më shumë se kurrë këtë vëmendje, se është përgjegjësia jonë, e këtij parlamenti të garantojmë akses, gjithëpërfshirje dhe të ngrihet statusi “student” e “pedagog”.

Nga ana tjetër, çfarë po ndodh me arsimin profesional? Sot nuk ka asnjë politikë zhvillimi konkrete në këtë drejtim.

Arsimi profesional duhej të kishte luajtur një rol kyç në afrimin e tregut të punës me të rinjtë. Po ku gjendet sot arsimi profesional, do të pyesni ju. Është në një cep aty nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, se ju e larguat nga ministrja e Arsimit dhe sot është nën hijen e saj.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka rolin kryesor, me ligj, për nxitjen dhe koordinimin e punës për arsimin dhe formimin profesional, por nuk ka as edhe një buxhet dedikuar kësaj agjencie. AKPA-ja do të rinovohet, patjetër, por a do të ketë buxhet të rinovojë nismat drejt arsimit profesional?

Dua të përmend këtu qarkun e Durrësit, i cili, siç e pamë edhe dje nga deklaratat e Kryeministrit, është një qark me potencial të lartë, me disa zona industriale dhe zona me biznese të ndryshme, por akoma nuk ka asnjë hap drejt promovimit apo të investimit në arsimin profesional. Pse nuk ka asnjë plan pune në këtë drejtim? Pse nuk e përafroni biznesin me universitetet, me shkollat profesionale? Pse nuk siguron trajnime për mësuesit dhe t'i mbështesni financiarisht që ata të ngrihen në nivelin e kërkuar?

Duke kaluar nga njëri projekt në tjetrin, dua të ndalem te një pikë e rëndësishme si projekti i Korridorit Adriatiko-Jonian, që është në të vërtetë një projekt kombëtar. Këtu përmend projektin segmentin e rrugës Thumanë-Kashar. A reflektohet në buxhet ky projekt? Më lejoni të pyes: çfarë do të ndodhë me shpronësimet? Nëse e keni parë edhe nga zhvillimet e fundit, banorët po dalin në protesta. Përse? Sepse nuk ka transparencë, sepse nuk ka informacion!

Është e treta herë që nga kjo foltore i drejtohem qeverisë me pyetjen: çfarë do të ndodhë me qytetarët? Pse nuk ka transparencë? Pse i lini qytetarët në mëshirë të fatit, duke pritur ditën që t'u shembet prona dhe nuk do të shpronësohen siç e meritojnë? Ku është projekti për rrugën? Cilat shtëpi do të shemben? Cilat prona do të shpronësohen? Pse nuk keni ofruar minimumin e informacionit?

Ah, kështu e mbroni ju qytetarin? Kjo është mbrojtja që i ofroni qytetarit, apo mbrojtja që i ofroni pronës? Po t'ju ndodhte ju, jam e sigurt që asnjërin nga këto gjëra nuk do ta toleronit.

E, pra, si çdo gjë tjetër, edhe buxheti sot nuk është i plotë, sjell premtime, objektiva, por nuk tregon projekte konkrete se si do të zhvillohen këto strategji dhe këta objektiva.

Prandaj po largohen shqiptarët sot, prandaj po largohet rinia sot!

Brezat e rinj e kanë humbur besimin te ju, ndërkohë ju vini sot këtu me disa letra, me disa shifra që nuk reflektojnë asgjë, asnjë politikë zhvillimore, se ju po abuzoni dita-ditës me nderin e tyre dhe me vlerat e kësaj shoqërie!

E, pra, kjo është arsyeja përse këtë buxhet unë do ta votoj kundër. Faleminderit!